



TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

Emri i NSH-së:	NSH Deva ("Ndërmarrja")
Emri i Ndërmarrjes së Re:	Ndërmarrja e Re Deva Uzina e Përpunimit të Gazrave SH.P.K. ("Ndërmarrja e Re")
Vendndodhja:	Gjakovë, Kosovë
Biznesi/Spektori:	Prodhim
Prodhimet:	Përpunim gazrash teknike: acetilen, propan-butan, oksigjen dhe dyoksid karboni
Tregu:	Gjakova në veçanti dhe mbarë Kosova në përgjithësi.
Konkurrenca:	Ka disa konkurrent lokal të vegjël.
Punonjësit:	Momentalisht, 40 punëtor janë të përfshirë në Ndërmarrjen e Re.
Ndërtesat dhe tokat:	<p>Asetet kryesore të Ndërmarrjes së Re, siç janë regjistruar në Fletën Poseduese nr. 31, ZK "Zidi i Sadik Agës", Komuna Gjakovë, përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none">• Parcela e tokës industriale nr. 98 me sipërfaqe totale rreth 08.21.00 ha, dhe;• Kompleksi i objekteve industriale, pajisur me makineri përpunimi të gazrave teknike me sipërfaqe të përgjithshme rreth 3860m² identifikuar në aero fotografinë e më poshtme, siç vijon:<ul style="list-style-type: none">- objekti i mbushjes së Oksigjenit dhe Dioksidit të Karbonit;- objekti i mbushjes së Acetilenit;- objekti i mbushjes së Propan Butanit me stacionin e pompave; dhe 2 rezervuarë;- trafoja elektrike;- stacioni i ajrit;- stacioni i hidroforëve;- objekti i administratës dhe ngrohtorja qendrore;- depoja e gazeve, dhe;- objekti i portës.

Shënim: brezi i tokës prej 3-5m gjerësi përgjatë kufirit lindor, jugor dhe jug-perëndimor të Ndërmarrjes së Re ishte dedikuar nga Ndërmarrja si rrugë publike për pronarët e tokave private fqinjë. Nëse sigurohet evidencë dhe vërtetohet legjitimiteti i vendimit eventual të Ndërmarrjes për dhënien e të drejtës tek pronarët privat për qasje në tokat të tyre (rrugë) nëpërmes tokës së Ndërmarrjes, do të bëhen matje në teren dhe përcaktohet kufiri i saktë i tokës së Ndërmarrjes së Re, si dhe të përcaktohet kufiri në anën veriore të tij duke lënë kështu jashtë parcelës nr. 98 dhe të pa prekur rrugën

përgjatë tërë kufirit të saj siç është kufizuar tani me rrethoja. Nëse ridefinohet kufiri sipas gjendjes ekzistuese në teren, sipërfaqja e tokës së transferueshme tek Ndërmarrja e Re do të jetë rreth 77600m². Në të kundërtën është obligim i blerësit të ri të trajtoj këtë çështje dhe të përcaktoj kufirin e pronës që do t'i bartet Ndërmarrjes së Re. Andaj, nevojiten matje saktësuese.

Detyrimet që do të barten:

Për Ndërmarrjen e Re aplikohen këto detyrime:

- (1) Detyrimet neto të NSh-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobot, të cilat janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (2) Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë shfaqur gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (4) Shpenzimet e furnizimeve me mallra dhe shërbime (duke mos përfshirë rrogat, pensionet apo pagesa tjera tek apo në emër të të punësuarve të NSh-së në kapacitetin e tyre si të punësuar) që akumulohen gjatë kursit normal të biznesit të:
 - a) akumuluar gjatë periudhës tre mujore duke përfunduar në datën e hyrjes në fuqi të deklaratës relevante të transferit;
 - b) pa paguar deri në atë ditë dhe i atribuohen biznesit të NSh-së.

Imazh nga Aero Inçizimi i Ndërmarrjes së Re:



Informatat:

Departamenti i Shitjes
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 -1255
Fax: + 381 (0) 38 248 076

Asnjë informacion rreth ndërmarrjes paraqitur në këto të dhëna nuk është e garantuar. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dokumentet për ofertim. Ata të cilët dëshirojnë të dorëzojnë ofertë duhet të bazohen në hulumtimin e tyre. Investitorët e mundshëm rekomandohen të kryejnë hulumtimin e tyre paraprak para se të dorëzojnë ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të dhëna për ndërmarrjen janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme lidhur me dhënien e informatave publikut mbi kandidatët për privatizim dhe mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: <http://www.pak-ks.org>



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

www.pak-ks.org

**Dokumentet e
Ofertimit:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rr. Ilir Konushevci Nr.8
10000 Pristinë, Kosovë

Asnjë informacion rreth ndërmarrjes paraqitur në këto të dhëna nuk është e garantuar. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dokumentet për ofertim. Ata të cilët dëshirojnë të dorëzojnë ofertë duhet të bazohen në hulumtimin e tyre. Investitorët e mundshëm rekomandohen të kryejnë hulumtimin e tyre paraprak para se të dorëzojnë ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të dhëna për ndërmarrjen janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme lidhur me dhënien e informatave publikut mbi kandidatët për privatizim dhe mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: <http://www.pak-ks.org>